

SEKSIONI XI

TEKSTILET DHE ARTIKUJT TEKSTILE

Shënime

1. Ky Seksion nuk përfshin:

- (a) Qimet apo krifat e kafshëve për bërjen e furçave (kreu 0502); qimet e kalit apo mbeturinat e tij (kreu 0503) ;
- (b) Flokët e njerëzve apo artikujt e flokëve të njerëzve (kreu 0501, 6703 apo 6704), përveçse rrobës së fortë të një lloji të përdorur zakonisht në presimin e vajit apo të ngjashmeve të tij (kreu 5911);
- (c) Push pambuku apo materialet e tjera vegjetale të Kapitullit 14;
- (d) Asbesti i kreut 2524 apo artikujt e asbestit apo produkte të tjera të kreut 6812 apo 6813;
- (e) Artikujt e kreut 3005 apo 3006; fije të përdorura për pastrimin e hapësirës midis dhëmbëve (pe për të pastruar dhëmbët), në paketa për shitjen individuale me pakicë, të kreut 3306;
- (f) Tekstilet e ndjeshme ndaj dritës të krerëve 3701 deri 3704;
- (g) Monofilamentet prej të cilëve çdo dimension kryq seksional i kalon 1 mm apo shiritat dhe të ngjashmet e tyre (p.sh., kashta artificiale) me një gjerësi të jashtme me tepër se 5 mm, prej plastike (Kapitulli 39), apo gërshetime apo pëlhura apo punë të tjera xunkthi prej monofilamenteve të tillë apo shiritave të tillë (Kapitulli 46);
- (h) Pëlhura të endura, të thurura me një file apo me shumë file, shajak apo pëlhura të pa endura, të ngopura, të veshura, të mbuluara apo të laminuara me plastike, apo artikujt prej tyre, të Kapitullit 39 ;
- (ij) Pëlhura të endura, të thurura me një file apo me shumë file, shajak dhe pëlhura të pa endura, të ngopura, veshura, mbuluara apo të laminuara me gomë, apo artikujt prej tyre, të Kapitullit 40;
- (k) Lëkurët e papërpunuara me leshin apo flokët mbi to (Kapitulli 41 apo 43) apo artikujt prej gëzofi, të gëzofit artificial apo artikujt prej tyre, të kreut 4303 apo 4304;
- (l) Artikujt prej materialeve tekstile të kreut 4201 apo 4202;
- (m) Produktet apo artikujt e Kapitullit 48 (p.sh., mbushjet celulozike);
- (n) Mbathjet e këmbëve apo pjesët e mbathjeve të këmbëve, dollaqa apo gjunjakët apo artikuj të ngjashëm të Kapitullit 64;
- (o) Rrjetat e flokëve apo artikuj të tjerë për kokën apo pjesët e tyre të Kapitullit 65;
- (p) Mallrat e Kapitullit 67;
- (q) Materiale tekstile të veshura me abraziv (kreu 6805) dhe gjithashtu fibrat e karbonit apo artikujt e fibrave të karbonit të kreut 6815 ;
- (r) Fibra xhami apo artikuj prej fibrave të xhamit, ndryshe nga qëndismat me fije xhami mbi një bazë të dukshme prej pëlhure (Kapitulli 70);
- (s) Artikujt e Kapitullit 94 (p.sh., mobilieritë, pajisjet e fjetjes, llambat dhe pajisjet ndriçuese);

- (t) Artikujt e Kapitullit 95 (p.sh., lodrat, pajisjet sportive apo rrjetat sportive apo të lojërave);
- (u) Artikujt e Kapitullit 96 (për shembull, furçat, grupet e mallrave për qepje të përdorura në udhëtim, zinxhirët rrëshqitës dhe shiritat e makinave të shkrimit); peshqirët sanitare(vat)dhe tamponat,pecetat(pelena)dhe pelenat për foshnje); apo
- (v) Artikujt e Kapitullit 97.
2. (A) Mallrat e klasifikueshme në Kapitullin 50 deri 55 apo në kreun 5809 apo 5902 dhe prej një **përzierjeje prej dy apo më shumë materialesh** tekstile do të klasifikohen sikur përbëhen tërësisht nga një prej atyre materialeve tekstile që predominon ndaj peshës mbi çdo nga materialet e tjera të vetme tekstile.
- Kur asnjë prej materialeve tekstile nuk predominon në peshë, mallrat do të klasifikohen sikur përbëhen tërësisht nga një prej atyre materialeve tekstile i cili është i përfshirë nga kreu që ndodhet i fundit në rendin numerik midis atyre që konsiderohen të barabarta.
- (B) Për qëllimet e rregullit të mësipërm:
- (a) Fijet prej flokëve të kalit në formë spirale (kreu 5110) dhe fijet e metalizuara (kreu 5605) do të trajtohen si një material i vetëm tekstili pesha e të cilëve do të merret si agregat i peshave të komponentëve të tij;për klasifikimin e pëlhurave të endura, fija metalike do të konsiderohet si material tekstili;
- (b) Zgjedhja e përshtatshme e kreut do të ndikohet nga përcaktimi së pari e Kapitullit dhe pastaj kreun e zbatueshëm brenda këtij Kapitulli, pa marrë në konsiderate ndonjë material jo të klasifikueshëm në atë Kapitull;
- (c) Kur të dy Kapitujt 54 dhe 55 janë të përfshirë në ndonjë Kapitull tjetër, Kapitujt 54 dhe 55 do të trajtohen si një Kapitull i vetëm;
- (d) Kur një Kapitull apo një kre i referohet mallrave prej materialeve të ndryshme tekstile, të tilla materiale do të trajtohen si një material i vetëm tekstili.
- (C) Rregullat e paragrafëve (A) dhe (B) më lart zbatohen gjithashtu për fijet e referuara në Shënimin 3, 4, 5 apo 6 më poshtë.
3. (A) Për qëllimet e këtij Seksioni, dhe nënshtruar ndaj përjashtimeve në paragrafin (B) më poshtë, fijet (njësh, të shumëfishta apo kabëll fijesh) e përshkrimeve të mëposhtme do të trajtohen si "**spango, korda, litarë dhe kablllo**":
- (a) Prej mëndafshi apo mbeturinave të tij, me masë më shumë se 20,000 decitex;
- (b) Prej fibrave të bëra nga njerëzit (përfshirë fije prej dy apo më shumë monofilamenteve të Kapitullit 54), me masë më shumë se 10,000 decitex;
- (c) Prej kërpi apo liri të vërtetë:
- (1) I Ilustrosur apo i zmaltuar, me masë 1,429 decitex apo me shumë; apo
- (2) Jo i Ilustrosur apo i zmaltuar, me masë më shumë se 20,000 decitex;
- (d) Prej fibrave të lëvozhgës së arrës së kokosit, e përbërë nga tre apo më shumë shtresa;
- (e) Prej fibrave të tjera vegjetale, me masë më shumë se 20,000 decitex; apo
- (f) Të përforcuara me fije metalike.
- (B) Përjashtime:
- (a) Fije prej leshi apo prej qimeve të tjera kafshore dhe fije letre, përveçse fijeve të përforcuara me një fije metalike;
- (b) Litarët e filamenteve të bëra nga njerëzit të Kapitullit 55 dhe fijet shumë filamente pa dredhje apo me një dredhje prej më pak se 5 rrotullime për metër të Kapitullit 54;

- (c) Zorrët e krimbit të mëndafshit të kreut 5006, dhe monofilamentet e Kapitullit 54;
 - (d) Fijet e metalizuara të kreut 5606; fijet e përforcuara me fije metalike i nënshtrohen paragrafit (A) (f) me lart; dhe
 - (e) Fijet me flokë, fije në formë spirale dhe fije me tegel të trashur për laqe të kreut 5606.
4. (A) Për qëllime të Kapitujve 50, 51, 52, 54 dhe 55, shprehja "**vendosur për shitjen me pakicë**" në lidhje me fijet ka kuptimin, nënshtuar ndaj përjashtimeve të paragrafit (B) me poshtë, e fijeve (njësh, të shumëfishta apo kabëll fijesh) vendosur:
- (a) Mbi karda, rele, tuba apo mbështetës të ngjashëm, të një peshe (përfshirë mbështetësen) jo më tepër se:
 - (1) 85 g në rastin e fijeve të mëndafshit, të mëndafshit mbeturinë apo fijeve të filamenteve të bëra nga njerëzit; apo
 - (2) 125 g në raste të tjera;
 - (b) Në toptha, torcka apo shtëllunga të një peshe jo më tepër:
 - (1) 85 g në rastin e fijeve të filamenteve të bëra nga njerëzit prej më pak se 3,000 decitex, të mëndafshit apo të mëndafshit mbeturine;
 - (2) 125 g në rastin e të gjitha fijeve të tjera prej më pak se 2,000 decitex; apo
 - (3) 500 g në rastet e tjera;
 - (c) Në torcka apo shtëllunga të përbëra nga disa torcka apo shtëllunga me të vogla të ndara nga fije të veçanta të cilat i japin atyre pavarësi nga njëra tjetra, secila të një peshe uniforme jo më tepër se:
 - (1) 85 g në rastin e fijeve të mëndafshit, të mbeturinave të tij apo të fijeve prej filamenteve të bëra nga njerëzit; apo
 - (2) 125 g në rastet e tjera.
- (B) Përjashtimet:
- (a) Fije e vetme prej çdo materiali tekstil, përveç:
 - (1) Fije e vetme prej leshi apo prej qimeve të holla të kafshëve, të pazbardhura; dhe
 - (2) Fije e vetme prej leshi apo prej qimeve të holla të kafshëve, të zbardhuara, të lyera apo të stampuara, me masë më shumë se 5,000 decitex;
 - (b) Fije të shumëfishta apo kabëll fijesh, të pazbardhura:
 - (1) Prej mëndafshi apo prej mbeturinash mëndafshi, megjithatë të vendosur, apo
 - (2) Prej materialeve të tjera tekstile përveçse prej leshi apo prej qimesh të holla kafshësh, në torcka apo shtëllunga;
 - (c) Fije të shumëfishta apo kabëll fijesh prej mëndafshi apo mbeturinash mëndafshi, të zbardhuara, të lyera apo të stampuara, me masë 133 decitex apo më pak; dhe
 - (d) Fije e vetëm, të shumëfishta apo kabëll fijesh prej çdo materiali tekstil:
 - (1) Në torcka apo shtëllunga të pështjellë kryq; apo
 - (2) Vendosur në mbështetës apo në mënyra të tjera për të treguar përdorimin e tij në industrinë tekstile (p.sh., mbi masure, tuba të makinerive të dredhjes, bobina, bobina apo boshte rotullues konike, apo të vulosur në formë të kukuleve për tezgjahët e qëndismave).

5. Për qëllimet e kërkuara 5204, 5401 dhe 5508 shprehja "**fije për qepje**" nënkupton fijet e tufave të shumëfishta apo të kablllove:

- (a) Vendosur mbi mbështetëse (p.sh., rule, tuba) të një peshe (përfshirë mbështetësen) jo më tepër se 1,000 g;
- (b) Të barazuara për tu përdorur si fije për qepje; dhe
- (c) Me një rotullim apo dredhje finale "Z".

6. Për qëllime të këtij Seksioni, shprehja "**fije të viskozitetit të lartë**" nënkupton fijet që kanë një viskozitet, të shprehur në cN/tex (centi Njuton për tex), më të madh se sa të mëposhtmet:

- Fije e vetme prej najloni apo poliamideve të tjerë, apo prej poliesterëve60 cN/tex
- Fije të shumëfishta apo kablllo fijesh prej najloni apo prej poliamideve të tjerë apo prej poliesterëve 53 cN/tex
- Fije e vetme, të shumëfishta apo kablllo fijesh prej mëndafshi artificial27 cN/tex

7. Për qëllime të këtij Seksioni, shprehja "**ndërtuar**" nënkupton:

- (a) E prerë ndryshe nga katrori apo drejtkëndëshi;
- (b) Prodhuar në gjendje përfundimtare, të gatshme për përdorim (apo thjesht kanë nevojë për ndarje duke prerë fijet ndarëse) pa u qepur apo punë t e tjera (p.sh., marrësit e caktuar të pluhurave, peshqirët, mbulesat e tavolinës, shallet katrore, batanijet);
- (c) të prera në madhësi dhe me të paktën një avantazh ngrohje-mbyllur me një kufi dukshëm të ngushtuara ose i ngjeshur dhe skajet e tjera trajtohen si përshkruhet në çdo nën paragrafët e tjera të këtij shënimi, por pëlhura duke përjashtuar skajet prerë e të cilave kanë qenë të penguar nga përfundimi duke i prerë të nxehtë apo me mjete të tjera të thjeshta;
- (d) Me buzë të palosura apo të rumbullakosura, apo me thekë të bërë nyje nga çdo anë, por përjashtoj pëlhurat, anët e prera të të cilave janë evituar nga koklavitjet prej goditjeve apo mjeteve të tjera të thjeshta;
- (e) Prerë në përmasa dhe që kanë përshkruar një proces të punës së tërheqjes së fillit;
- (f) Bashkuar nga qepja, ngjitja apo ndryshe (përveç mallrave në copa të përbëra nga dy apo më shumë gjatësi prej materialeve identike bashkuar fund me fund dhe mallrat në copa të përbëra prej dy apo më shumë tekstile të bashkuara në shtresa, nëse janë apo jo të mbushura);
- (g) Të thurura me një file apo më shumë file sipas formave, nëse paraqiten apo jo si artikuj të ndare veç apo në formë të një numri artikujsh në gjatësi.

8. Për qëllime të Kapitujve 50 deri 60 :

- (a) Kapitujt 50 deri 55 dhe 60 dhe, veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, Kapitujt 56 deri 59 nuk zbatohen për mallrat e ndërtuar brenda kuptimit të Shënimit 7 më lart; dhe
- (b) Kapitujt 50 deri 55 dhe 60 nuk zbatohen për mallrat e Kapitujve 56 deri 59.

9. Pëlhurat e endura të Kapitujve 50 deri 55 përfshijnë pëlhurat e përbëra nga shtresa prej fijeve tekstile paralele mbivendosur mbi njëra-tjetrën në kënd akut (me pak se 90°) apo në kënd të drejtë. Këto shtresa janë lidhur tek kryqëzimet e fijeve me anë të një ngjitësi apo me anë të lidhjes termale.

10. Produktet elastike të përbëra prej materialeve tekstile të kombinuar me fije gome do të klasifikohen në këtë Seksion.

11. Për qëllime të këtij Seksioni, shprehja "**ngopur**" përfshin "e zhytur".

12. Për qëllime të këtij Seksioni, shprehja "**poliamide**" përfshin "aramide".

13. Për qëllime të këtij seksioni dhe kudo tjetër të aplikuar, në tërë nomenklaturën, shprehja 'fije elastomerike' nënkupton fije të filamenteve, përfshirë monofilamentet, prej materiali tekstil sintetik, ndryshe nga fijet e teksturuara, të cilat nuk këputën kur zgjaten tre herë më tepër se gjatësia e tyre origjinale dhe të cilat kthehen, pasi janë zgjatur në dyfishin e gjatësisë së tyre origjinale, brenda një periudhe prej 5 minutash, në një gjatësi jo më të madhe se 1 herë e gjysmë të gjatësisë së tyre origjinale.

14. Derisa konteksti ta kërkojë ndryshe, artikuj tekstile të veshjes, të krerëve të ndryshëm do të klasifikohen në krerët e tyre të vetëm edhe nëse janë të vendosur në grup për shitjen me pakicë. Për qëllimet e këtij Shënimi, shprehja "artikuj tekstile të veshjes" nënkupton veshjet e krerëve 6101 deri 6114 dhe krerëve 6201 deri 6211.

Shënime të nën krerëve

1. Në këtë Seksion dhe, ku është e zbatueshme, gjatë gjithë Nomenklaturës, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna bashkëgjatë tyre:

(a) '*Fije të pazbardhura*'

Fije të cilat:

- (1) Kanë ngjyrën natyrale të fibrave të tyre përbërëse dhe nuk janë zbardhur, lyer (nëse janë apo jo në masë) apo nuk janë stampuar; apo
- (2) Janë më ngjyrë të papërcaktuar ("fije gri") , prodhuar nga fijet e hequra prej pëlthurave.

Të tilla fije mund të jenë trajtuar me një përpunim pa ngjyrë apo ngjyerje të paqëndrueshme (të cilat zhduken thjesht pas larjes me sapun) dhe , në rastin e fibrave të bëra nga njerëzit, janë trajtuar në masë me agjente dellustrues (p.sh., dioksid titaniumi).

(b) *Fije të zbardhura*

Fije të cilat:

- (1) kanë përshkruar një proces zbardhjeje, janë bërë nga fibra të zbardhura apo, derisa konteksti ta kërkojë ndryshe, janë të lyera të bardha (po ose jo në masë) apo trajtuar me një veshje të bardhe;
- (2) përbëhen nga një përzierje e fibrave të pazbardhura me ato të zbardhura; apo
- (3) janë të shumëfishta apo kablo fijesh dhe përbëhen nga fije të zbardhura dhe të pazbardhura.

(c) *Fije të ngjyrosura (të lyera apo të stampuara)*

Fije të cilat:

- (1) janë lyer (po ose jo në masë) ndryshe nga të bardha apo ndryshe nga në një ngjyrë të paqëndrueshme, apo të stampuara, apo janë bërë nga fibra të lyera apo të stamposura;
- (2) përbëhen nga një përzierje e fibrave të lyera me ngjyra të ndryshme apo nga një përzierje prej fibrave të zbardhura apo të pazbardhura me fibra të ngjyrosura (fije mergel apo të përzieria), apo janë stampuar me një apo më shumë ngjyra në intervale për të dhënë idenë e njollave;
- (3) janë fituar nga tufa apo fitila që janë stampuar; apo
- (4) janë të shumëfishta apo kablo fijesh dhe përbëhen nga fije të zbardhura apo të pazbardhura dhe fije të ngjyrosura.

Përcaktimet e mësipërme zbatohen gjithashtu, hap pas hapi, për monofilamentet dhe për shiritat apo të ngjashmet e tyre të Kapitullit 54.

(d) *Pëlatura të endura të pazbardhura*

Pëlatura të endura të bëra nga fije të pazbardhura dhe të cilat nuk janë të zbardhura, të lyera apo të stamposura. Pëlatura të tilla mund të jenë trajtuar me veshje pa ngjyrë apo me ngjyrosës të paqëndrueshëm .

(e) *'Pëlatura të endura të zbardhura'*

Pëlatura të endura të cilat:

- (1) janë zbardhur apo, derisa konteksti ta kërkojë ndryshe, janë lyer të bardha apo trajtuar me një veshje të bardhë, në copa;
- (2) janë të përbëra nga fije të zbardhura; apo
- (3) janë të përbëra nga fije të zbardhura dhe të pazbardhura.

(f) *'Pëlatura të endura të lyera'*

Pëlatura të endura të cilat

- (1) janë lyer me një ngjyrë të vetme uniforme ndryshe nga e bardhë (derisa konteksti ta kërkojë ndryshe) apo janë trajtuar me një finiture të ngjyrosur ndryshe nga e bardhë (derisa konteksti ta kërkojë ndryshe) në copa; apo
- (2) përbëhen nga fije të ngjyrosura të një ngjyrë të vetme uniforme.

(g) *'Pëlatura të endura prej fijeve të ngjyrave të ndryshme.'*

Pëlatura të endura (ndryshe nga pëlatura të endura të stampuara) të cilat:

- (1) përbëhen nga fije të ngjyrave të ndryshme apo fije të nuancave të ndryshme të së njëjtës ngjyrë (ndryshe nga ngjyra natyrore e fibrave përbërëse);
 - (2) përbëhen nga fije të pazbardhura apo të zbardhura dhe fije të ngjyrosura; apo
 - (3) përbëhen nga fije mergel apo të përziera
- (Në të gjitha rastet, fijet e përdorura në anët dhe fundet e copave nuk do të merren në konsideratë).

(h) *'Pëlatura të endura të stamposura'*

Pëlatura të endura të cilat janë stampuar në copa, nëse janë apo jo të bëra nga fije të ngjyrave të ndryshme.

(Të mëposhtmet do të vlerësohen gjithashtu si pëlatura të endura të stampuara: pëlatura të endura që mbajnë dizeno të bëra, p.sh., me një furçe apo pistolte sprucioje, nëpërmjet letër transferueses, flokëzimit apo nëpërmjet procesit batik.)

Procesi i mercerizimit nuk ndikon në klasifikimin e fijeve apo të pëlaturave brenda kategorive të mësipërme.?

Përcaktimet nga (d) deri (h) mësipër zbatohet, *mutatis, mutandis*, tekstilet e thurur apo thurur me grep.

(ij) *'Endje e thjeshtë'*

Një ndërtim i pëlhurave në të cilën çdo fije e indit kalon alternativisht mbi dhe nën fijeve pasardhëse të bazës dhe çdo fije e bazës kalon alternativisht mbi dhe nën fijeve pasardhëse të indit.

2. (A) Produktet e Kapitujve 56 deri 63 që përmbajnë dy apo më shumë materiale tekstile do të vlerësohen si të përbëra tërësisht nga ai material tekstili i cili mund të zgjidhet sipas shënimit 2 të këtij Seksioni për klasifikimin e një produkti të Kapitujve 50 deri 55 apo të kreut 5809 të përbëra nga materiale të njëjta tekstile.

(B) Për aplikimin e këtij rregulli:

(a) ku është e përshtatshme , vetëm pjesë të cilat përcaktojnë klasifikimin sipas Rregullit Interpretativ 3 do të merren në konsideratë;

(b) në rastin e produkteve tekstile të përbëra nga një pëlhurë bazë dhe një sipërfaqe pushi apo me laqe, pëlhura bazë nuk do të llogaritet;

(c) në rastin e qëndismave të kreut 58.10 dhe mallrat prej tyre, vetëm pëlhura bazë do të merret në konsideratë. Por megjithatë, qëndismat pa bazë të dukshme, dhe mallrat prej tyre, do të klasifikohen me referencë vetëm për fijen e qëndismave.